



Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 8 shkurt 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtësit për Konstatim sipas Nenit 28(4)(b)(i) të Kodit
të Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët (Konflikt Interesash)**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues" ose "Trupi Gjykues II"), në bazë të neneve 21(4)(e) dhe 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), rregullës 26(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), dhe nenit 28(3)(b) dhe (4)(b)(1) të Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Kodi i Etikës Profesionale"),¹ lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 6 nëntor 2020, Administratorja emëroi Venkatesvari Alagendrën ("znj. Alagendra") si mbrojtëse për Jakup Krasniqin ("z. Krasniqi").²
2. Më 14 dhjetor 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit shqiptoi aktgjykimin e apelit në çështjen kundër Salih Mustafës ("z. Mustafa"), në të cilin la në fuqi verdiktin e fajësisë së z. Mustafa³ për krime të luftës të kryera në Zllash në prill 1999.⁴
3. Më 3 janar 2024, Administratorja miratoi kërkesën e z. Mustafa për zëvendësimin e mbrojtësit të tij, z. Julius von Bone, dhe emëroi znj. Alagendra si mbrojtëse të zgjedhur nga ai vetë.⁵

¹ KSC-BD-07/Rev1/2021, 28 prill 2021.

² F00058, Administratorja, *Njoftim për Emërimin e Mbrojtësit për Jakup Krasniqin*, 6 nëntor 2020, me Shtojcën 1, konfidenciale.

³ *Shih* KSC-BC-2020-05, F00494/RED3/COR, Trupi Gjykues I, *Version i Redaktuar më Tej i Versionit të Korrigjuar të Versionit të Redaktuar Publik të Aktgjykimit* ("Aktgjykimi Mustafa"), 24 janar 2023 (data e Aktgjykimit origjinal: 16 dhjetor 2022).

⁴ KSC-CA-2023-02, F00038/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit të Apelit*, 14 dhjetor 2023.

⁵ *Shih* F02084/A01, Mbrojtësja, *Shtojca 1 e Kërkesës së Mbrojtëses për Konstatim sipas Nenit 28(4)(b)(i) të Kodit të Etikës Profesionale*, 26 janar 2024, konfidenciale dhe *ex parte*.

4. Më 18 janar 2024, Administratorja informoi Trupin Gjykses II dhe palët e pjesëmarrësit në këtë proces gjyqësor për emërimin e znj. Alagendra si mbrojtëse të z. Mustafa.⁶
5. Më 25 janar 2024, në bazë të kundërshtimit të Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS"),⁷ Paneli i Gjykatës Supreme konstatoi se: (i) pa një konstatim të Trupit Gjykses II se nuk ekziston konflikt interesash, Administratorja nuk duhej ta kishte emëruar znj. Alagendra si përfaqësuese të z. Mustafa; (ii) vendimi i Administratores për emërimin e znj. Alagendra nuk ka fuqi ligjore; dhe (iii) znj. Alagendra do të duhet ta njoftojë Trupin Gjykses II në përputhje me nenin 28(4)(b)(1) të Kodit të Etikës Profesionale, nëse synon të përfaqësojë z. Mustafa.⁸
6. Më 26 janar 2024, znj. Alagendra i drejtoi Trupit Gjykses II kërkesë për konstatim sipas nenit 28(4)(b)(i) të Kodit të Etikës Profesionale ("Kërkesa").⁹
7. Më 29 janar 2024, duke mbajtur parasysh kërkesën e znj. Alagendra për shqyrtim sa më të shpejtë të Kërkesës,¹⁰ Trupi Gjykses ndryshoi afatet dhe informoi palët dhe pjesëmarrësit se: (i) nëse dëshirojnë t'i përgjigjen Kërkesës, t'i dorëzojnë përgjigjet deri në orën 4 pasdite, të hënën, më 5 shkurt 2024; dhe se (ii) kundërpërgjigjet ndaj përgjigjeve, nëse do të ketë, duhet të dorëzohen deri të mërkurën, 7 shkurt 2024 ("Korrespondenca e 29 Janarit 2024").¹¹

⁶ F02066, Administratorja, *Njoftim i Emërimit të Venkatesvari Alagendrës si Mbrojtëse e Salih Mustafës* ("Njoftimi i 18 Janarit 2024"), 18 janar 2024, me Shtojcat 1-2, konfidenciale dhe *ex parte*.

⁷ KSC-SC-2024-02, F00006, Prokurorja e Specializuar, *Kundërshtim i Prokurorisë ndaj Emërimit të Mbrojtëses*, 23 janar 2024.

⁸ KSC-SC-2024-02, F00008, Paneli i Gjykatës Supreme, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë në lidhje me Konflikt Interesash të Mbrojtëses* ("Vendimi i Panelit të Gjykatës Supreme"), 25 janar 2024, para. 9, 11.

⁹ F02084, Mbrojtësja e Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtëses për Konstatim sipas Nenit 28(4)(b)(i) të Kodit të Etikës Profesionale*, 26 janar 2024, konfidenciale, me Shtojcat 1-4, konfidenciale dhe *ex parte*.

¹⁰ Kërkesa, para. 3, 41.

¹¹ CRSPD423, *Mesazh Elektronik (email) i Trupit Gjykses II drejtuar NJAGJ-së në lidhje me Përshpejtimin e Afateve në lidhje me F02084*, 29 janar 2024, konfidencial.

8. Më 5 shkurt 2024, ZPS-ja dhe Mbrojtja e Kadri Veselit (“Mbrojtja e Veselit”) dorëzuan përgjigjet e tyre ndaj Kërkesës (përkatësisht, “Përgjigja e ZPS-së” dhe “Përgjigja e Veselit”).¹²

9. Më 7 shkurt 2024, znj. Alagendra iu kundërpërgjigj Përgjigjes së ZPS-së (“Kundërpërgjigja”).¹³

II. PARASHTRIMET

10. Znj. Alagendra kërkon që Trupi Gjykses të konstatojë se nuk ekziston konflikt interesash që do të pengonte emërimin e saj si mbrojtëse e z. Mustafa.¹⁴ Ajo në veçanti parashtron se: (i) sa u përket fakteve në dy çështjet gjyqësore, ato nuk kanë lidhje në masë të konsiderueshme mes veti; dhe (ii) në këtë fazë, nuk ka tregues se argumentet e mbrojtjes së z. Mustafa dhe asaj të z. Krasniqi do të binin ndesh me njëri-tjetrin, apo se do të lindte konflikt interesash nga dëshmia (për t’u) dhënë nga z. Mustafa.¹⁵ Znj. Alagendra gjithashtu parashtron se z. Mustafa dëshiron ta emërojë si mbrojtëse dhe se, si z. Krasniqi, ashtu edhe z. Mustafa, kanë dhënë pëlqimin për përfaqësimin e njëkohshëm të tyre prej saj.¹⁶ Ajo më tej argumenton se faza aktuale e procesit të z. Mustafa është relevante për vlerësimin e konfliktit të interesave.¹⁷ Gjithashtu, ajo shton se në rrethanat aktuale, kufizimi i të drejtës së z. Mustafa për të zgjedhur mbrojtësin do të ishte

¹² F02102, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë në lidhje me Kërkesën e Mbrojtëses për Konstatim sipas Nenit 28(4)(b)(i) të Kodit të Etikës Profesionale*, 5 shkurt 2024, konfidenciale; F02103, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit në lidhje me Kërkesën e Mbrojtëses për Konstatim sipas Nenit 28(4)(b)(i) të Kodit të Etikës Profesionale (F02084)*, 5 shkurt 2024, konfidenciale.

¹³ F02110, Mbrojtësja e Specializuar, *Kundërpërgjigje e Mbrojtëses ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Kërkesën e Mbrojtëses për Konstatim sipas Nenit 28(4)(b)(i) të Kodit të Etikës Profesionale*, 7 shkurt 2024, konfidenciale.

¹⁴ Kërkesa, para. 1, 17, 40. *Shih gjithashtu Kërkesën*, para. 2, 22, 25.

¹⁵ Kërkesa, para. 22, 25-37.

¹⁶ Kërkesa, para. 1, 24, i referohet (Shtojcave 1-2 të) Njoftimit të 18 Janarit 2024.

¹⁷ Kërkesa, para. 25, 28-29.

i papërligjur, do të dobësonte këtë të drejtë, dhe do të përbënte cenim të rëndë të së drejtës së tij për të kërkuar mbrojtjen e ligjshmërisë.¹⁸

11. ZPS-ja përgjigjet se Trupi Gjykes duhet të konstatojë se ekziston konflikt interesash që pengon përfaqësimin e z. Mustafa prej znj. Alagendra.¹⁹ ZPS-ja parashtron se Kërkesa kërkon të imponojë një standard vërtetimi më të lartë se sa duhet, që do ta bënte të pamundur zgjidhjen aktive të konflikteve të interesave.²⁰ ZPS-ja gjithashtu parashtron se duke mbajtur parasysh përkimin e konsiderueshëm midis dy çështjeve gjyqësore dhe konfliktin e interesave që shkaktohet, përfaqësimi i njëkohshëm i z. Krasniqi dhe z. Mustafa prej znj. Alagendra mund të dëmtojë rëndë dhe në mënyrë të pakthyeshme interesat e klientëve të saj dhe interesat më të gjerë të drejtësisë.²¹ ZPS-ja në veçanti argumenton se: (i) detyrimi i konfidencialitetit të znj. Alagendra ndaj njërit klient mund të bjerë ndesh me detyrimin e besnikërisë ndaj klientit tjetër në situata kur merr informacion të privilegjuar;²² dhe (ii) kjo mund ta pengojë në përshtatjen e një strategjie të caktuar, apo në paraqitjen e parashtrimeve të caktuara në emër të njërit klient, për të mos i dëmtuar interesat e klientit tjetër.²³ Sipas ZPS-së, një konstatim për moslejimin e përfaqësimit të z. Mustafa nga znj. Alagendra, nuk do të shkaktojë asnjë dëm dhe në fund mund të ndihmojë kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të proceseve.²⁴ Për këtë arsye, ZPS-ja vlerëson se Trupi Gjykes duhet të parandalojë në mënyrë aktive lindjen e një konflikti të tillë, dhe rrjedhimisht të garantojë drejtësinë dhe integritetin e proceseve.²⁵

12. Mbrojtja e Veselit përgjigjet se, mbi bazën e fakteve të njohura aktualisht, nuk parashikon të lindë ndonjë konflikt dhe nuk është në dijeni të asnjë arsyeje që

¹⁸ Kërkesa, para. 38-40.

¹⁹ Përgjigjja e ZPS-së, para. 1, 15.

²⁰ Përgjigjja e ZPS-së, para. 2, 5.

²¹ Përgjigjja e ZPS-së, para. 2. *Shih gjithashtu, p.sh.,* Përgjigjen e ZPS-së, para. 3, 8-9.

²² Përgjigjja e ZPS-së, para. 6, 10.

²³ Përgjigjja e ZPS-së, para. 7, 9, 10-11.

²⁴ Përgjigjja e ZPS-së, para. 12.

²⁵ Përgjigjja e ZPS-së, para. 13.

do të pengonte përfaqësimin e z. Mustafa nga znj. Alagendra.²⁶ Sipas Mbrojtjes së Veselit, përfaqësimi i z. Mustafa nga znj. Alagendra nuk do të shkaktonte vonesa në procesin e Çështjes 06 dhe nuk do të dëmtonte përfaqësimin e z. Krasniqi në Çështjen 06, as interesat më të gjerë të drejtësisë.²⁷

13. Mbrojtja e Veselit gjithashtu vuri në dukje se për momentin nuk synon të thërrasë z. Mustafa si dëshmitar.²⁸

14. Në Kundërpërgjigjen e vet, znj. Alagendra i qëndron mendimit se Trupi Gjykues duhet ta miratojë Kërkesën.²⁹ Ajo parashtron se Përgjigja e ZPS-së: (i) është spekulative; (ii) nuk vërteton ekzistencën e një konflikti interesash apo të një rreziku të mjaftueshëm për materializimin e një konflikti të tillë në të ardhmen; dhe (iii) vendos një standard tejet të ulët për konstatimin e një konflikti interesash, që rrjedhimisht i pamundëson një të akuzuari të zgjedhë vetë mbrojtësin.³⁰ Ajo gjithashtu parashtron se në Përgjigjen e vet, ZPS-ja: (i) interpreton gabimisht Kërkesën kur pretendon se znj. Alagendra 'pranoi' se dy çështjet gjyqësore kanë lidhje në masë të konsiderueshme me njëra-tjetrën brenda kuptimit të nenit 28(3)(b) të Kodit të Etikës Profesionale; dhe (ii) i jep shumë pak rëndësi pëlqimit të dhënë prej z. Mustafa dhe z. Krasniqi.³¹ Znj. Alagendra gjithashtu kundërshton argumentin e ZPS-së se mund të shkaktohen vonesa në proces³² dhe parashtron se anashkalimi i të drejtës themelore të z. Mustafa për të zgjedhur vetë mbrojtësin do të shkaktonte dëm të pandreqshëm.³³

²⁶ Përgjigja e Veselit, para. 1-2, 5.

²⁷ Përgjigja e Veselit, para. 2, 4.

²⁸ Përgjigja e Veselit, para. 3.

²⁹ Kundërpërgjigja, para. 12.

³⁰ Kundërpërgjigja, para. 1, 3-4, 8-9. *Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 6, 10.*

³¹ Kundërpërgjigja, para. 5-7.

³² Kundërpërgjigja, para. 10.

³³ Kundërpërgjigja, para. 11.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

15. Sipas nenit 21(4)(e) të Ligjit, në përcaktimin e akuzave kundër të akuzuarit sipas Ligjit, i akuzuari ka të drejtën të mbrohet përmes mbrojtësit të specializuar të zgjedhur prej tij;³⁴

16. Sipas nenit 40(2) të Ligjit, Trupi Gjykses siguron që gjykimi të jetë i drejtë dhe i shpejtë dhe që procesi të kryhet në përputhje me Rregulloren, duke i respektuar plotësisht të drejtat e të akuzuarve.

17. Sipas nenit 28(3)(b) të Kodit të Etikës Profesionale, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në nenin 28(4), mbrojtësi nuk këshillon, përfaqëson apo vepron në emër të një klienti në një çështje para Dhomave të Specializuara nëse mbrojtësi është duke këshilluar, përfaqësuar apo vepruar, ose ka këshilluar, përfaqësuar ose vepruar në emër të një klienti në një çështje para Dhomave të Specializuara që ka lidhje në masë të konsiderueshme.

18. Sipas nenit 28(4)(b)(1) të Kodit të Etikës Profesionale, nëse lind një konflikt faktik apo i mundshëm interesash sipas nenit 28(3), në cilëndo fazë të procesit, mbrojtësi njofton me shkrim Administratoren dhe merr pëlqimin e çdo klienti i cili ka gjasë të ketë pasoja dhe njofton panelin ose panelet përkatëse, i cili përcakton ose të cilët përcaktojnë nëse ekziston konflikt interesash.

IV. DISKUTIM

A. PËRGJIGJJA E VESELIT

19. Është e diskutueshme nëse Mbrojtja e Veselit ka të drejtën e përgjigjes në lidhje me pikën e debatuar këtu. Sidoqoftë, Trupi Gjykses thekson se Korrespondenca e 29 Janarit 2024 mund të interpretohet se sugjeron se iu miratoi

³⁴ Shih gjithashtu nenin 30(5) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Article 6(3)(c) of the European Convention on Human Rights; Article 14(3)(d) of the International Covenant on Civil and Political Rights.

të gjitha palëve të drejtën për parashtrimin e përgjigjeve. Në këto rrethana, Trupi Gjykses nuk do të marrë vendim nëse Mbrojtja e Veselit ka të drejtën e përgjigjes.

20. Megjithatë, Trupi Gjykses rikujton se afati që caktoi për dorëzimin e përgjigjeve për të gjitha palët dhe pjesëmarrësit ishte ora 4 e pasdites, 5 shkurt 2024.³⁵ Përgjigjja e Veselit u dorëzua në orën 7:40 të mbrëmjes më 5 shkurt 2024. Mbrojtja e Veselit nuk kërkoi zgjatje të afatit dhe rrjedhimisht dorëzoi përgjigjen me vonesë. Sido që të jetë, duke qenë se parashtrimi me vonesë i përgjigjes nuk i shkaktoi dëm asnjë pale ose pjesëmarrësi, Trupi Gjykses do të bëjë një përjashtim dhe do ta pranojë përgjigjen e Veselit si të vlefshme.

B. FUSHËVEPRIMI/KUADRI I KËTIJ VENDIMI

21. Paneli i Gjykatës Supreme tashmë ka përcaktuar se “përfaqësimi i z. Mustafa nga znj. Alagendra bie brenda rrethanave/situatave të përcaktuara në nenin 28(3)(b) të Kodit të Etikës Profesionale, përkatësisht kur mbrojtësi e përfaqëson një klient në një çështje para Dhomave të Specializuara që ka lidhje në masë të konsiderueshme me një çështje tjetër, duke qenë se ajo përfaqëson z. Krasniqi”.³⁶ Trupit Gjykses II tani i kërkohet të konstatojë, në bazë të nenit 28(4)(b)(i) të Kodit të Etikës Profesionale, nëse ekziston konflikt faktik apo i mundshëm interesash midis emërimit të znj. Alagendra si mbrojtëse e z. Krasniqi në këtë proces gjyqësor (“Çështja 06”), dhe emërimit të ardhshëm të saj si mbrojtëse e z. Mustafa. Në lidhje me këtë, në bazë të Kërkesës dhe parashtrimeve të tjera të protokolluara në Çështjen 06, Trupi Gjykses e ka të qartë se problemi i ekzistencës së një konflikti interesash parashtrohet kryesisht në lidhje me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë që z. Mustafa synon të paraqesë në të ardhmen.³⁷ Ky është skenari që

³⁵ *Shih* më lart, para. 7.

³⁶ Vendimi i Panelit të Gjykatës Supreme, para. 8.

³⁷ *Shih*, *p.sh.*, Kërkesën, para. 13-15, 28, 39, 41; Shtojcat 1-2 të Njoftimit të 18 Janarit 2024 (“[...]për të apeluar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme të DHSK-së [...]”).

do të shërbejë si bazë për konstatimin e Trupit Gjykues nëse ekziston konflikt interesash.

C. KONSTATIMI I KONFLIKTIT FAKTIK OSE TË MUNDSHËM INTERESASH

22. Sipas jurisprudencës ndërkombëtare, një konflikt interesash lind kur, për shkak të rrethanave të caktuara, përfaqësimi prej mbrojtësit dëmton, ose mund të dëmtojë interesat e klientit dhe interesat më të gjera të drejtësisë.³⁸ Është konstatuar se ekziston konflikt interesash në rrethana kur, për shembull, për shkak të detyrimit të besnikërisë të mbrojtësit, përfaqësimi i njëkohshëm i dy klientëve do të kufizonte zgjedhjen e strategjive të mbrojtjes së njërit ose të dy klientëve.³⁹ Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ka konstatuar gjithashtu se një konflikt interesash mund të evidentohet më lehtësisht në rastet kur mbrojtësi përfaqëson dy të akuzuar, të cilët, të paktën pjesërisht, akuzohen për të njëjtat vepra penale, të kryera gjatë të njëjtës periudhë kohore dhe në të njëjtën zonë gjeografike.⁴⁰

³⁸ Shih, p.sh., ICTY, *Simić et al.*, IT-95-9, Trial Chamber, [Decision on the Prosecution Motion to Resolve Conflict of Interest Regarding Attorney Borislav Pisarević](#) ("Simić et al. 25 March 1999 Decision"), 25 March 1999, f. 4; *Prlić et al.*, IT-04-74-AR73.1, Appeals Chamber, [Decision on Appeal by Bruno Stojić against Trial Chamber's Decision on Request for Appointment of Counsel](#) ("Prlić et al. 24 November 2004 Decision"), 24 November 2004, para. 22; *Prlić et al.*, IT-04-74-AR73.6, Appeals Chamber, [Decision on Appeals Against Decision Admitting Transcript of Jadranko Prlić's Questioning Into Evidence](#), 23 November 2007, para. 19; *Gotovina et al.*, IT-06-90-AR73.1, Appeals Chamber, [Decision on Mirsolav Šeparović's Interlocutory Appeal against Trial Chamber's Decision on Conflict of Interest and Finding of Misconduct](#), 4 May 2007, para. 23; *Gotovina et al.*, IT-06-90-AR73.2, Appeals Chamber, [Decision on Ivan Čermak's Interlocutory Appeal against Trial Chamber's Decision on Conflict of Interest of Attorney's Čedo Prodanović and Jadranka Sloković](#) ("Gotovina et al. 29 June 2007 Decision"), 29 June 2007, para. 16; ICTR, *Nahimana et al.*, ICTR-99-52-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 28 November 2007, para. 158.

³⁹ ICTY, *Mejakić et al.*, IT-02-65-AR73.1, Appeals Chamber, [Decision on Appeal by the Prosecution to Resolve Conflict of Interest Regarding Attorney Jovan Simić](#) ("Mejakić et al. 6 October 2004 Decision"), 6 October 2004, para. 15; *Gotovina et al.* [29 June 2007 Decision](#), para. 22-28; *Gotovina et al.*, IT-06-90-PT, Trial Chamber I, [Decision on Conflict of Interest of Attorneys Čedo Prodanović and Jadranka Sloković](#) ("Gotovina et al. 5 April 2007 Decision"), 5 April 2007, para. 11-19.

⁴⁰ ICTY, *Prlić et al.*, IT-04-74-PT, Trial Chamber I, [Decision on Requests for Appointment of Counsel](#), 30 July 2004, para. 16 (Shih gjithashtu *Prlić et al.* [24 November 2004 Decision](#), para. 24); *Gotovina et al.* [29 June 2007 Decision](#), para. 24.

23. Z. Krasniqi dhe z. Mustafa pjesërisht akuzohen për të njëjtat krime, përkatësisht për krimet që pretendohet të jenë kryer në Zllash në prill 1999.⁴¹ Sikurse u theksua më lart,⁴² z. Mustafa u shpall fajtor për këto krime në gjykimin e shkallës së parë dhe verdikti i fajësisë së tij u la në fuqi në shkallë të apelit.

24. Në bazë të Aktakuzës në Çështjen 06 dhe Dosjes Paraprake të ZPS-së në Çështjen 06,⁴³ Paneli vëren si vijon: (i) pretendohet se z. Krasniqi, së bashku me persona të tjerë, ishte pjesë e një Ndërmarrjeje Kriminale të Përbashkët ("NKP") dhe se krimet e paraqitura në Aktakuzë, përfshirë ato në Zllash, janë prova të asaj NKP-je dhe zbatim i saj;⁴⁴ (ii) në Çështjen 06 gjithashtu pretendohet se z. Mustafa ishte vartës i anëtarit të NKP-së së pretenduar në Çështjen 06, Rustem Mustafa, i cili, nga ana tjetër, pretendohet se ishte vartës i të akuzuarit;⁴⁵ (iii) me fjalë të tjera, z. Krasniqi akuzohet ndër të tjera për krimet që i atribuohen z. Mustafa (dhe ndihmësve të tij), si në bazë të teorisë së NKP-së, ashtu edhe në bazë të përgjegjësisë komanduese/eprore;⁴⁶ dhe (iv) lidhja e mundshme e vartësisë midis Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe zonave (duke përfshirë edhe zonën e Llapit ku vepronte z. Mustafa), është aspekt aktual në Çështjen 06.⁴⁷

⁴¹ Shih F00999/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar* ("Aktakuza në Çështjen 06"), 30 shtator 2022, konfidenciale, para. 75, 109, 160 (versioni publik me më pak redakte u dorëzua më 27 shkurt 2023, F01323/A01); KSC-BC-2020-05/F00011/RED/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Versionit të Redaktuar Publik të Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar, Parashtrimi KSC-BC-2020-05/F00011 i datës 19 qershor 2020, 2 tetor 2020, para. 5 dhe në vijim. Shih gjithashtu F00709/A01, Prokurori i Specializuar, Shtojca 1 e Parashtrimit të Korrigjuar të Dosjes Paraprake të Prokurorisë dhe të Kërkesave në lidhje e Të* ("Dosja Paraprake e ZPS-së në Çështjen 06"), 24 shkurt 2022, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, para. 203, 438-457 (versioni i redaktuar publik (F01415/A01) dhe versioni konfidencial me më pak redakte (F01594/A03), u dorëzuan përkatësisht më 3 prill dhe 9 qershor 2023).

⁴² Shih më lart, para. 2.

⁴³ Shih më lart, poshtëshënimin 41.

⁴⁴ Aktakuza në Çështjen 06, para. 32-54, 75, 109, 160, 176.

⁴⁵ Aktakuza në Çështjen 06, para. 35, 55-57, 176; Dosja Paraprake e ZPS-së në Çështjen 06, p.sh. para. 203, 439. Shih gjithashtu Aktgjykimin *Mustafa*, para. 339.

⁴⁶ Aktakuza në Çështjen 06, para. 32-57, 75, 109, 160, 176. Shih gjithashtu Dosjen Paraprake të ZPS-së në Çështjen 06, para. 267-268, 438-457.

⁴⁷ Shih, p.sh., Aktakuzën në Çështjen 06, para. 32-57; Dosja Paraprake e ZPS-së në Çështjen 06, p.sh. para. 12, 203, 267-268, 709-713.

25. Duke pasur parasysh aspektet në paragrafët 23-24 më lart, Trupi Gjykses është i mendimit se ka përkim të qenësishëm të fakteve midis dy çështjeve gjyqësore dhe akuzave përkatëse.

26. Sido që të jetë, Trupi Gjykuesi nënvizon fazën aktuale të procesit në lidhje me Mustafën, përkatësisht se: (i) ai u shpall fajtor në gjykimin në shkallë të parë dhe verdikti i fajësisë së tij u la në fuqi në shkallë të apelit; dhe (ii) mjetet e disponueshme juridike janë të kufizuara.⁴⁸ Në këto rrethana, argumentet mbrojtëse të z. Mustafa përgjithësisht janë trajtuar tashmë në gjykim dhe në apel. Trupi Gjykses në këtë fazë nuk ka arsye të dyshojë në vërtetësinë e pohimit të znj. Alagendra⁴⁹ se mbrojtja e z. Mustafa dhe ajo e z. Krasniqi nuk mbështeten dhe nuk do të mbështeten në argumente që zhvendosin fajin nga njëri te tjetri. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses gjithashtu vëren se parashtrimet e z. Alagendra sugjerojnë se argumentet e z. Mustafa në kërkesën e tij të ardhshme për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të jenë në lidhje me, për shembull, dënimin ose standardin ligjor të zbatuar për vrasjen e paligjshme.⁵⁰ Argumente të tilla nuk ka gjasa të ndikojnë në pozitën e Krasniqi. Gjithashtu, aktualisht nuk ka tregues konkretë se ndonjëra nga palët ka ndërmend të thërrasë z. Mustafa si dëshmitar në Çështjen 06, apo të thërrasë z. Krasniqi si dëshmitar në procesin në lidhje me z. Mustafa.⁵¹

27. Gjithashtu, Trupi Gjykses vë në dukje se si z. Mustafa, ashtu edhe z. Krasniqi kanë dhënë pëlqimin për përfaqësimin e njëkohshëm të tyre nga znj. Alagendra.⁵² Detyrimin e informimit me kohë dhe të plotë të çdo klienti që ka gjasë të ketë pasoja dhe marrjes së të gjitha hapave për eliminimin e një konflikti

⁴⁸ *Shih* nenin 48 të Ligjit.

⁴⁹ *Shih* Kërkesën, para. 25, 27. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 32-34; Kundërpërgjigjja, para. 4.

⁵⁰ Kërkesa, para. 28.

⁵¹ Për shembull, z. Mustafa nuk është në listën e dëshmitarëve të ZPS-së (*Shih* F01594, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim nga Prokuroria i Listës së Përditësuar të Dëshmitarëve dhe Versionit më pak të Redaktuar të Dosjes Paraprake*, 9 qershor 2023, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 2-3, konfidenciale), dhe Mbrojtja e Veselit bëri të ditur se aktualisht nuk synon të thërrasë z. Mustafa si dëshmitar (*Shih* Përgjigjen e Veselit, para. 3).

⁵² *Shih* Shtojcat 1-2 të Njoftimit të 18 Janarit 2024.

(të mundshëm) interesash dhe/ose marrjes së pëlqimit të plotë dhe të bazuar në informacion të klientëve përkatës, e ka vetëm mbrojtësi.⁵³ Pëlqimi i dhënë në përgjithësi duhet të konsiderohet si plotësisht i bazuar në informacion në rrethana kur nuk ka tregues për të kundërtën.⁵⁴ Nuk ka asnjë tregues se pëlqimi i dhënë nga z. Mustafa dhe z. Krasniqi nuk është i bazuar në informacion. Trupi Gjykues vëren gjithashtu se asnjëri nga të bashkakuzuarit me z. Krasniqi nuk ka kundërshtuar përfaqësimin e njëkohshëm të z. Krasniqi dhe z. Mustafa nga znj. Alagenda.⁵⁵

28. Megjithatë, pavarësisht nga aspektet e shtjelluara në paragrafët 26-27 më lart, përkimi i qenësishëm i fakteve midis dy çështjeve gjyqësore dhe akuzave përkatëse⁵⁶ ngre shqetësim për detyrimin e besnikërisë së znj. Alagenda ndaj klientit, dhe, nga një këndvështrim më i gjerë, për interesat e drejtësisë, sepse detyrimi i besnikërisë ndaj klientit mund të ndikojë në llojin e argumenteve që mund të paraqiten në emër të secilit prej klientëve.⁵⁷ Në veçanti, kjo mund të ndikojë në llojin e argumenteve të mbrojtjes së z. Krasniqi dhe asaj të z. Mustafa në lidhje me, ndër të tjera: (i) rolin dhe kompetencat e Shtabit të Përgjithshëm; (ii) marrëdhënien midis Shtabit të Përgjithshëm dhe zonave (përfshirë zonën e

⁵³ *Gotovina et al.* [29 June 2007 Decision](#), para. 34; ICC, *Bemba et al.*, ICC-01/05-01/13-306, Pre-Trial Chamber II, [Decision on the "Prosecution Submission on the Appointment of Defence Counsel" for Mr Fidèle Babala Wandu](#) ("Bemba et al. 1 April 2014 Decision"), 1 April 2014, para. 3; Mokom, ICC-01/14-01/22-70-Anx-Red, [Partially Dissenting Opinion of Judge Luz Del Carmen Ibáñez Carranza and Judge Solomy Balungi Bossa to Public Redacted Judgment on the Appeal of Maxime Jeoffroy Eli Mokom Gawaka against the Decision of Pre-Trial Chamber II of 25 March 2022 \[...\]](#), 19 July 2022, para. 6, referring to Bemba, ICC-01/05-01/08-769, Trial Chamber III, [Decision on the "Prosecution's Request to Invalidate the Appointment of Legal Consultant to the Defence Team"](#), 7 May 2010, para. 39.

⁵⁴ Martić, IT-95-11-PT, Trial Chamber, [Decision on the Appeal against Decision of Registry](#), 2 August 2002, p. 7; Prlić et al. [24 November 2004 Decision](#), para. 27; *Gotovina et al.* [5 April 2007 Decision](#), para. 20-22; *Gotovina et al.* [29 June 2007 Decision](#), para. 33; MICT, *Turinabo et al.*, MICT-18-116-PT, President, [Decision on Request for Review of Registrar's Decision](#), 25 January 2019, para. 39. Shih gjithashtu Bemba et al. [1 April 2014 Decision](#), para. 3, 9-10.

⁵⁵ Në lidhje me Mbrojtjen e Veselit, shih më lart, para. 12 (ku jepet përmbledhje e Përgjigjes së Veselit).

⁵⁶ Shih më lart, para. 23-25.

⁵⁷ Shih lidhur me këtë, p.sh., Prlić et al. [24 November 2004 Decision](#), para. 24; Tolimir et al., IT-05-88-PT, Trial Chamber II, [Decision on Appointment of Co-Counsel for Radivoje Miletić](#) ("Tolimir et al. 28 September 2005 Decision"), 28 September 2005, para. 29-30; *Gotovina et al.* [29 June 2007 Decision](#), para. 22-28.

Llapit ku vepronte z. Mustafa); (iii) lidhjen e vartësisë midis kryesve (të drejtpërdrejtë) të pretenduar dhe (disa nga) të akuzuarit në Çështjen 06; (iv) nëse krimet e pretenduara të z. Mustafa dhe ndihmësve të tij janë ose nuk janë provë e zbatimit të NKP-së së pretenduar kundër z. Krasniqi dhe të bashkakuzuarve të tjerë; (v) po ashtu, nëse krimet e kryera nga z. Mustafa dhe ndihmësit e tij janë krime të kryera nga elementë “keqbërës” apo në zbatim të politikës së pretenduar të UÇK-së; dhe (vi) në qoftë se ka ekzistuar marrëdhënie epror-vartës, nëse z. Krasniqi dhe/ose të bashkakuzuarit shkelën detyrimin e parandalimit dhe ndëshkimit në lidhje me krimet e kryera nga z. Mustafa dhe ndihmësit e tij.

29. Megjithëse, sikurse u theksua më lart,⁵⁸ Trupi Gjykues në këtë fazë nuk ka arsye të dyshojë në vërtetësinë e pohimit të znj. Alagendra se mbrojtja e z. Mustafa dhe ajo e z. Krasniqi nuk mbështeten dhe nuk do të mbështetet në argumente që zhvendosin fajin nga njëri te tjetri, mbi bazën e elementeve të lartpërmendura⁵⁹ Trupi Gjykues vlerëson se mbetet një mundësi mjaftueshëm reale për krijimin e një situate që do të binte ndesh me, ose të paktën do të ndikonte në strategjitë e mbrojtjes së dy klientëve. Përfaqësimi i njëkohshëm i z. Krasniqi dhe z. Mustafa nga znj. Alagendra mund, për shembull, të përbëjë faktor shkurajues për znj. Alagendra që si mbrojtëse e z. Krasniqi, të paraqesë prova se z. Mustafa (ose ndihmësit e tij) kryen krime për interesat vetjakë të tyre. Për më tepër, kjo mund të pengojë z. Alagendra që, për shembull, të thërrasë ose marrë në pyetje dëshmitarë të caktuar dhe/ose të kundërshtojë dëshmi të dëshmitarëve në Çështjen 06, për të mos dëmtuar interesat e z. Mustafa.⁶⁰

⁵⁸ Shih më lart, para. 26.

⁵⁹ Shih më lart, para. 23-25, 28.

⁶⁰ Në lidhje me këtë, shih gjithashtu, p.sh., *Mejakić et al.* [6 October 2004 Decision](#), para. 15; *Gotovina et al.* [5 April 2007 Decision](#), para. 11-19; *Gotovina et al.* [29 June 2007 Decision](#), para. 22-28; ICC, *Mokom*, ICC-01/14-01/22-70-Red, [Public Redacted Judgment on the Appeal of Maxime Jeoffroy Eli Mokom Gawaka against the Decision of Pre-Trial Chamber II of 25 March 2022 \[...\] \(“Mokom 19 July 2022 Judgment”\)](#), 19 July 2022, para. 62-63, 65.

30. Kjo, nga ana tjetër, mund të paraqesë rrezik për një nga elementet përbërëse të drejtësisë së procesit, përkatësisht supozimi se z. Krasniqi do të përfaqësohet në mënyrë efektive dhe të fuqishme në të gjitha fazat e procesit. Fakti që z. Krasniqi ka dhënë pëlqimin për përfaqësimin e z. Mustafa nga znj. Alagendra⁶¹ nuk lejon prezumimin se interesat nuk do të rrezikohen nga ky përfaqësim.⁶²

31. Fakti që proceset janë në kryerje e sipër në të dy çështjet gjyqësore, shton edhe më shumë shqetësimet. Megjithëse, pa dyshim, çështja e Mustafës është në një fazë të avancuar të procesit,⁶³ është e vështirë të vlerësohet se çfarë do të ndodhë apo mund të ndodhë në cilindo nga dy proceset, dhe nëse dhe si kjo do të ndikonte në procesin tjetër. Në lidhje me këtë, Trupi Gjyqësor mban parasysh parimin e përcaktuar në jurisprudencën ndërkombëtare se mbrojtja e interesave të drejtësisë dikton jo vetëm ekzistencën e një mekanizmi për eliminimin e konflikteve të interesave pasi ato të kenë lindur, por edhe për parandalimin e konflikteve të tilla para se ato të lindin.⁶⁴

32. Në bazë të vlerësimit të mësipërm, Trupi Gjyqësor konstaton se, megjithëse në këtë fazë nuk ka tregues të një konflikti *faktik* interesash, ekziston *mundësi* për konflikt interesash në qoftë se krahas emërimit si mbrojtëse e z. Krasniqi, znj. Alagendra do të përfaqësoje edhe z. Mustafa.

33. Gjithashtu, Trupi Gjyqësor dëshiron të theksojë se konstatimi i *mundësisë* për konflikt interesash nuk duhet të interpretohet si shprehje e mendimit të Trupit Gjyqësor se znj. Alagendra nuk mund ose nuk duhet, të emërohet

⁶¹ Shih Shtojcën 1 të Njoftimit të 18 Janarit 2024.

⁶² Shih gjithashtu Prlić et al. [24 November 2004 Decision](#), para. 27; Tolimir et al. [28 September 2005 Decision](#), para. 32; Gotovina et al. [29 June 2007 Decision](#), para. 32-35. Shih gjithashtu ICTY, Gotovina et al., IT-06-90-PT, Trial Chamber I, [Decision on Finding of Misconduct of Attorney Miroslav Šeparović](#), 6 March 2007, f. 4.

⁶³ Shih më lart, para. 2, 23. Shih gjithashtu, në lidhje me këtë, Tolimir et al. [28 September 2005 Decision](#), para. 31.

⁶⁴ Prlić et al. [24 November 2004 Decision](#), para. 25; Gotovina et al. [29 June 2007 Decision](#), para. 16, 28.

mbrojtëse e z. Mustafa. Për mendimin e Trupit Gjykses, atij nuk i kërkohet të përcaktojë se çfarë masash duhet ose mund të merren në këto rrethana për zvogëlimin e rrezikut të lindjes së një konflikti faktik interesash. Trupi Gjykses gjithashtu nuk është përpjekur të shqyrtojë pasojat e këtij rreziku duke pasur parasysh të drejtën ligjore dhe themelore të z. Mustafa për të zgjedhur vetë mbrojtësin. Për këto arsye, Trupi Gjykses nuk do të shqyrtojë parashtrimet e palëve në lidhje me këtë aspekt. Emërimi ose caktimi i një mbrojtësi janë çështje për të cilat vendos kryesisht Administratorja.⁶⁵ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk ka bërë dhe nuk do të bëjë balancimin midis interesave konkurrues, veçanërisht midis të drejtës së z. Mustafa për mbrojtës të zgjedhur prej tij,⁶⁶ interesave të tjerë të z. Mustafa dhe z. Krasniqi, dhe interesave të drejtësisë. Gjithashtu, Trupi Gjykses nuk do të shqyrtojë nëse mund të vendosen masa të tjera, të ndryshme nga mosemërimi i znj. Alagendra si mbrojtëse e z. Mustafa, që do të zvogëlonin mjaftueshëm mundësinë për konflikt interesash që do të ndikonte në të drejtat dhe interesat e z. Krasniqi, z. Mustafa dhe/ose interesat e drejtësisë.

V. KLASIFIKIMI

34. Duke qenë se Kërkesa, Përgjigjja e Veselit dhe Kundërpërgjigjja janë parashtruar si konfidenciale, Trupi Gjykses urdhëron palët që deri të enjten, 15 shkurt 2024, të dorëzojnë versionet e redaktuara publike të parashtrimeve përkatëse të tyre, ose të kërkojnë riklasifikimin e tyre.

⁶⁵ Shih rregullën 26(1) të Rregullores; KSC-BD-04/Rev1/2021, *Udhëzues Pune i Zyrës Administrative: Direktivë për Mbrojtësit*, 28 prill 2021, në veçanti, Kapitullin III.

⁶⁶ Shih, *p.sh.*, *Mejakić et al.* [6 October 2004 Decision](#), para. 8; *Prlić et al.* [24 November 2004 Decision](#), para. 19; *Bemba et al.* [1 April 2014 Decision](#), para. 5; *Mokom* [19 July 2022 Judgment](#), para. 57 dhe në vijim. Shih gjithashtu, *p.sh.*, ICC, *Yekatom and Ngaïssona*, ICC-01/14-01/18-837-Red, Trial Chamber V, [Public Redacted Version of Decision on the Prosecution Submission on the Appointment of Defence Counsel](#), 19 January 2021, para. 6; ECtHR, *Croissant v. Germany* [GC], no. 13611/88, [Judgment](#), 25 September 1992, para. 29; *Meftah and Others v. France* [GC], nr. 32911/96, 35237/97 dhe 34595/97, [Judgment](#), 26 July 2002, para. 45; *Dvorski v. Croatia* [GC], no. 25703/11, [Judgment](#), 20 October 2015, para. 78-82.

35. Lidhur me Përgjigjen e ZPS-së që është parashtruar si konfidenciale, Trupi Gjykses vë në dukje se ZPS-ja nuk kundërshton riklasifikimin e saj si publike.⁶⁷ Duke qenë se Përgjigjja e ZPS-së nuk përmban informacion konfidencial, Trupi Gjykses urdhëron Zyrën Administrative të riklasifikojë Përgjigjen e ZPS-së si publike.

VI. VENDIM

36. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **KONSTATON** se ekziston *mundësi* për konflikt interesash në qoftë se krahas emërimit si mbrojtëse e z. Krasniqi, znj. Alagendra, do të përfaqësonte edhe z. Mustafa;
- b) **URDHËRON** palët që deri **të enjten, 15 shkurt 2024**, të dorëzojnë versionet e redaktuara publike të Kërkesës, Përgjigjes së Veselit dhe Kundërpërgjigjes, ose të kërkojnë riklasifikimin e tyre; dhe
- c) **URDHËRON** Zyrën Administrative të riklasifikojë përgjigjen e ZPS-së (F02102) si publike.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E enjte, 8 shkurt 2024

Në Hagë, Holandë.

⁶⁷ Përgjigjja e ZPS-së, para. 14.